



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

nr. 4685 prot

dt. 17.11.2020

V E N D I M

Nr. 41, datë 17.11.2020

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONAT E DËMTUARA PIKËSORE, PËR 50 BANESA INDIVIDUALE, BASHKIA MIRDITË”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr.22, datë 25.05.2020 vendosi “Të miratojë rindërtimin në të njëjtin truall, të njërive individuale të banimit të vlersuara për shembje referuar akt-ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Mirditë Nr. 70, datë 21.07.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Nr.11, datë 09.04.2020 dhe Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Nr. 40, datë 28.07.2020,

VENDOSA:

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 50 banesa Individuale, Bashkia Mirditë, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
 - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore;
 - b) Materiali hartografik:
 - i. Harta e Përdorimit të Tokës dhe Projektimit Urban;
 - ii. Harta e Infrastrukturave dhe Mbrojtjes së Tokës;
 - c) Paketa e Planvendosjeve për banesat individuale.
2. Miratohet rindërtimi në Zonat e Dëmtuara Pikësore, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, me qëllim rindërtimin e objekteve të cilat

referuar akt-ekspertizës së thelluar dhe oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 50 banesa Individuale, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.
4. Plani i Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 50 banesa Individuale, të integrohet me dokumentin e Planifikimit në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”*, të ndryshuar.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

K R Y E T A R I

NDREC DEDAJ

